



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 05 gusht 2025
Nr. ref.: VMP 2754/25

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO84/25

parashtrues

Komuna e Graçanicës

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr.05/218 të 28 gushtit 2024 të
Qeverisë së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtrues i kërkesës

- Kërkesa KO154/24 është dorëzuar nga Komuna e Graçanicës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga Negovan Šaranović, avokat nga Graçanica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr.05/218] të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 28 gusht 2024 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar) dhe të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 10 shtator 2024.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në përputhshmëri me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat] dhe 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, për të pezulluar *ex lege* hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Vendimit të kontestuar, deri në vendosjen në meriat të kërkesës nga Gjykata.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 71 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 2 prill 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 7 prill 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR.KO85/24], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese, dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO85/24], Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Radomir Laban dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
8. Më 14 prill 2025, Gjykata i njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) parashtruesin e kërkesës; (ii) Kryeministrin në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (iii) Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejme: MMPHI); (iv) Ministrinë e Pushtetit dhe Administrimit Lokal (në tekstin e mëtejme: MAPL); (v) Kuvendin Komunal të Komunës së Graçanicës. Gjykata i njoftoi palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, deri më 30 prill 2025.
9. Gjykata vëren se (i) Kryeministri, MMPHI, MAPL kanë pranuar më 14 prill 2025 njoftimin për regjistrimin e kërkesës dhe mundësinë e paraqitjes së komenteve; ndërsa (ii) Kuvendi Komunal i Komunës së Graçanicës e ka pranuar më 16 prill 2025, megjithatë asnjëra nga palët e lartpërmendura nuk kanë dorëzuar komente brenda afatit të përcaktuar në njoftimet e dorëzuara.

10. Më 31 korrik 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e gjyqtarës raportuese përkitazi me vendimin për masën e përkohshme. Po të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi për (i) miratimin e kërkesës për masë të përkohshme, në kohëzgjatje deri më 31 tetor 2025; dhe (ii) pezullimin e zbatimit të Vendimit të kontestuar deri në afatin e lartcekur.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 28 gusht 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Vendimin e kontestuar [Nr.05/218]. Vendimi i kontestuar ka hyrë në fuqi më 10 shtator 2024, në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
12. Në vijim, Gjykata do të reflektojë përmbajtjen e Vendimit të kontestuar:

“Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 gusht 2024, merr këtë

VENDIM

- 1. Qeveria e Republikës së Kosovës shpall interes publik ndërtimin e qendrës rezidenciale për autizëm, sindromë daun dhe aftësi të kufizuar për fëmijë, persona të rritur dhe të moshë së shtyrë.*
- 2. Në qëllim të realizimit të interesit publik nga pika 1. e këtij Vendimi, sipërfaqet kadastrale të paraqitura në këtë Vendim, i jepen në shfrytëzim Shoqatës Bamirëse “Jetimët e Ballkanit” për ndërtimin e Kompleksit “Qendra Rezidenciale e Kosovës për autizëm, sindromë daun, dhe aftësi të kufizuar për fëmijë, persona të rritur dhe të moshës së shtyrë” në periudhë prej 99 vitesh.*
- 3. Sipërfaqet/pjesët e ngastrave kadastrale Nr.150-0, 155-0 dhe 17-8 në pronësi të Komunës së Graçanicës, barten në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për realizimin e interesit publik sipas pikës 1. të këtij Vendimi. Pas bartjes, me fuqi të këtij Vendimi, të njëjtat do ti jepen në shfrytëzim shoqatës bamirëse nga pika 2. e këtij Vendimi.*
- 4. Sipërfaqet/pjesët e ngastrave kadastrale të cekura në pikën 3. të këtij Vendimi dhe sipërfaqet/pjesët e ngastrave Nr.154-0 dhe 36-0 në pronësi të Republikës së Kosovës, i jepen në shfrytëzim Shoqatës Bamirëse “Jetimët e Ballkanit” për nevoja të ndërtimit të Kompleksit “Qendra Rezidenciale e Kosovës për autizëm, sindromë daun, dhe aftësi të kufizuar për fëmijë, persona të rritur dhe të moshës së shtyrë” sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.*
- 5. Obligohet Agjencia Kadastrale e Kosovës të kryej të gjitha veprimet procedurale dhe gjeodezike (matjet dhe ndarjet) dhe të bëj bartjen e sipërfaqeve/pjesëve të ngastrave të cekura në pikën 3. dhe 4. të këtij Vendimi dhe tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi, në emër të Shoqata “Jetimët e Ballkanit” me seli në Prishtinë.*
- 6. Parcelat (pjesët e sipërfaqeve) të dhëna në shfrytëzim sipas këtij Vendimi do të shfrytëzohen vetëm për ndërtimin e Kompleksit “Qendra Rezidenciale e Kosovës për autizëm, sindromë daun, dhe aftësi të kufizuar për fëmijë, persona të rritur dhe të moshës së shtyrë” dhe destinimi i shfrytëzimit pa pëlqim (vendim) nga Qeveria e Republikës së Kosovës e Republikës së Kosovës nuk mund të ndërrohet.*

7. Në rast të mosshfrytëzimit të ngastrave për destinimin e caktuar në këtë vendim, Shoqatë Bamirëse “Jetimët e Ballkanit” i merret e drejta e shfrytëzimit.
8. Nëse pas ndërtimit të Kompleksit “Qendra Rezidenciale e Kosovës për autizëm, sindromë daun, dhe aftësi të kufizuar për fëmijë, persona të rritur dhe të moshës së shtyrë”, Shoqata bamirëse “Jetimët e Ballkanit” nuk e shfrytëzon Kompleksin ai i kthehet në shfrytëzim Qeverisë së Republikës së Kosovës.
9. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturrës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës, duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, sipas të cilit mund të kontestojë para Gjykatës kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt, konteston kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr.05/218] të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 28 gusht 2024. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës, pretendon se Vendimi i sipërcituar bie ndesh me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] të Kushtetutës.
14. Përkitazi me aktin e kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendon se procesi i miratimit të të njëjtit nuk ishte transparent, gjithëpërfshirës, por i njëanshëm dhe përjashtues, duke marrë parasysh që Komuna e Graçanicës para miratimit të tij (i) nuk ishte njoftuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës apo Ministria kompetente e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturrës; (ii) nuk është konsultuar gjatë përgatitjes së projektit të ndërtimit të qendrës banesore që do të realizohej në territorin e Komunës, gjë që prodhon pasoja për Komunën e Graçanicës dhe kjo ka të bëjë me synimin e Qeverisë për të hequr pjesë të njësive kadastrale në një sipërfaqe të konsiderueshme që janë në pronësi të Komunës; si dhe (iii) si rrjedhojë e mosnjoftimit e moskonsultimit, “Komuna e Graçanicës nuk i di detajet e mënyrës dhe kriterëve sipas së cilave është vendosur dhe për çfarë arsye është përzgjedhur për ndërtimin e një objekti banesor për Organizatën bamirëse “Jetimat e Ballkanit” me një periudhë të shfrytëzimit prej 99 vitesh në vend lokacionin specifik ku është i nevojshëm ndërtimi, vetë sipërfaqja e objektit dhe karakteristikat e tij dhe detaje tjera të rëndësishme për të gjithë projektin.”
15. Parashtruesi i kërkesës vijon pretendimet e tij, duke theksuar se: “Qeveria e Republikës së Kosovës e ka marrë Vendimin e kontestuar duke iu referuar nenit 16, paragrafit 1 të Ligjit nr. 08/L-125 për Pronën Publike, por në kundërshtim me zakonet e mira të respektimit të interesave të palës tjetër dhe pa marrë parasysh dispozitat tjera ligjore, që duhet të respektohen kur bëhet fjalë për pronën publike.”
16. Parashtruesi i kërkesës, në vijim thekson se “Në kuptim të nenit 5 të Ligjit nr.08/L-125 për pronën publike parashikohen parimet mbi të cilat bazohet administrimi i pronës publike, përkatësisht parimet e ligjshmërisë, publicitetit, parashikueshmërisë, ekonomizimit dhe përgjegjësisë, të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës i ka shkelur duke nxjerrë Vendimin nr.05/218 pa asnjë konsultim me pronarin e pronës të cilit i konfiskohet prona, këtu paditësi. Gjithashtu, neni 15 paragrafi 4 i Ligjit nr. nr.08/L-

125 për pronën publike përcakton qartë se bartja e të drejtave pronësore "... bëhet përmes procedurave transparente dhe konkurruese.....". Nëse dispozita e lartcekur nuk respektohet, paragrafi 5 i nenit 15 të Ligjit nr. 08/L-125 për pronën publike parasheh si në vijim "Vendimi apo kontrata e lidhur në kundërshtim me parimet e përcaktuara me këtë nen janë nule". Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës shton se është evidente se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Ligjit të sipërcituar, të cilave u është referuar me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar.

17. Në vazhden e argumentimit të pretendimeve, parashtruesi i kërkesës potencon se në pajtim me nenin 14 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ka të drejtë në posedim dhe administrim të pronës së vet të luajtshme dhe paluajtshme dhe se kompetencat e vetëqeverisjes lokale parashikohen në ligjin e sipërpërmendur dhe nuk mund të derogohen dhe largohen me ligje të tjera. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se " [...] me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ai juridiksion është i kufizuar në atë mënyrë që pa konsultim dhe miratim paraprak, komunës së Graçanicës i hiqet e drejta për të administruar pronën e saj. Qeveria e Republikës së Kosovës, gjithashtu, me rastin e vendosjes, nuk e ka marrë parasysh ndjeshmërinë se në pyetje është një komunë me shumicë serbe, edhe pse ndjeshmëria për komunitetet dhe komunat me shumicë serbe njihen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale. Me miratimin e vendimit të lartpërmendur, Qeveria e Republikës së Kosovës e kufizon komunën e Graçanicës, këtu paditësin, në ushtrimin e kompetencave vetanake të parapara me nenin 17 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat nuk mund të kufizohen dhe as hiqen me ligje tjera".
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i përket kategorisë kushtetuese të ligjeve me interes vital dhe si i tillë nuk mund të anashkalohet dhe as të zvogëlohen kompetencat e vetëqeverisjes lokale duke iu referuar ligjeve të tjera, që në rastin konkret është Ligji nr. 08/L-125 për Pronën Publike.
19. Sipas parashtruesit të kërkesës, miratimi i njëanshëm i Vendimit të kontestuar ka për pasojë që për parcelën nr. 17-8 ZK Graçanicë të parashikojë konfiskimin e një pjese të konsiderueshme dhe se Komuna e Graçanicës ka planet e saj më të vjetra për parcelën e përmendur, të cilat janë me interes publik për Komunën dhe qytetarët e saj, të cilat i ka listuar si në vijim:

"Kuvendi i Komunës së Graçanicës në bazë të kërkesës së Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" (nr. 2944/19, të 16.04.2019), nxori Vendimin nr. 6499/19 të 27. 08. 2019, në të cilën një pjesë e parcelës nr. 17-8 ZK Graçanicë i është dhënë me qira për një periudhë 99 vjeçare për ndërtimin e një ndërtese administrative për kompaninë rajonale Ujësjetllësi "Prishtina". Komuna e Graçanicës është në proces të zbatimit të vendimit të lartpërmendur, në bazë të të cilit më vonë do të përcaktohet një pjesë e parcelës, e cila do t'i dorëzohet për shfrytëzim. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës rrezikon zbatimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës nr. 6499/19 të 27.08.2019 dhe përfundimit të projektit të filluar.

- Komuna e Graçanicës - Departamenti për Zhvillim Ekonomik dhe Integrim me kompaninë

"Competence Center for Green Energy" që nga viti 2022 është në procesin e negociatave për arritjen e mundshme të marrëveshjes së bashkëpunimit që përfshin parcelën nr. 17-8 ZK Graçanicë me një sipërfaqe prej disa dhjetëra hektarësh për ndërtimin e një parku diellor me kapacitet 4h5 MW.

Instituti për Planifikim Hapësinor i Kosovës e ka shënuar parcelën nr. 17-8 ZK Graçanicë si zonë me potencial për zhvillimin e energjisë diellore dhe të erës. Duke pasur parasysh vlerën e projektit i cili sigurisht arrin në miliona euro. Instituti Hapësinor i Kosovës e ka shënuar parcelën nr. 17-8 KZ Graçanica si një zonë me potencial për zhvillimin e energjisë diellore dhe të erës dhe zhvillimin ekonomik të mëtejshëm të komunës së Graçanicës dhe mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuptim të gjerë. Përmes Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës seriozisht rrezikohet zbatimi dhe kërcënohet dështimi i projektit dhe pasojat eventuale të tij do t'i bartë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komuna e Graçanicës në parcelën lëndore nr. 17-8 KZ Graçanicë tashmë ka objekte të ndërtuara që mbulojnë një sipërfaqe të konsiderueshme të parcelës 17-8 ZK Graçanicë, dhe këto janë ndërtesat e mëposhtme:

- Ndërtesa administrative komunale me sipërfaqe rreth 30 ari;
- Shtëpi për të moshuarit me sipërfaqe rreth 15 ari;
- Shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore me një sipërfaqe prej rreth 30 ari;
- Inkubator social me sipërfaqe rreth 10 ari;
- ndërtesa e ndërmarrjes së ujësjellësit të destinuar për përpunimin e ujit me një sipërfaqe prej rreth 1 hektar;
- varreza e re në Graçanicë me kapelë me sipërfaqe rreth 50 ari;
- Është planifikuar ndërtimi i objektit administrativ për Ndërmarrjen Publike "Ekologjia" me sipërfaqe rreth 50 ari.

Përveç parcelës së përmendur nr. 17-8 ZK Graçanica ka rreth 80% të sipërfaqes së saj të mbuluar me pyll, që paraqet një aset të një rëndësie të veçantë. Parcela nr. 150-o ZK Graçanicë shtrihet përgjatë rrugës ekzistuese, një pjesë e së cilës është e asfaltuar, ndërsa parcelën nr. 155-o ZK Graçanicë nuk është e mundur të identifikohet në Gjeoportalin e Kosovës".

20. Sipas parashtruesit të kërkesës, Qeveria e Republikës së Kosovës me marrjen e Vendimit të kontestuar në mënyrë të njëanshme nuk ka marrë parasysh, ndër të tjera, se rrezikon interesat e përgjithshme, zhvillimore dhe ekonomike të Komunës së Graçanicës dhe qytetarëve të saj dhe Vendimi në fjalë është akt administrativ në formë të dekretit, që është në kundërshtim me parimet e demokracisë, sepse me shqiptimin e vendimit të kontestuar, cenohen interesat e Komunës së Graçanicës dhe në masë më të madhe cenohet kontributi i saj në zhvillimin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.
21. Parashtruesi i kërkesës rithekson se Vendimi i kontestuar kërcënon drejtpërdrejt interesat e Komunës së Graçanicës si njësi e vetëqeverisjes lokale për sa i përket investimeve dhe projekteve të planifikuara, të gjitha me synim të arritjes së të ardhurave shtesë për rritjen e buxhetit.
22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: "Vendimi i kontestuar i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/218 i 28.08.2024 në mënyrë flagrante dhe të drejtpërdrejtë kërcënon interesat e komunës së Graçanicës duke ia konfiskuar pronën e saj nga Qeveria e Republikës së Kosovës e Republikës së Kosovës, ku interesi për ndërtimin e një qendre rezidenciale për autizëm, sindromën Doën dhe aftësi të kufizuara për fëmijë dhe të moshuar kërcënon projektet tashmë të filluara që përfundimisht do të rezultojnë me një rritje të buxhetit".

Kërkesa për Masë të Përkohshme

23. Sipas parashtruesit të kërkesës, duke pasur parasysh se *“Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë ka ndërmarrë hapa për ndërtimin e objektit, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës Kushtetuese që në përputhje me nenin 27 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të vendosë masën e përkohshme, me të cilën do të shtyjë ekzekutimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.05/218 të 28.08.2024 deri në nxjerrjen e vendimit nga ana e Gjykatës”*.
24. Tutje, parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata duhet të ketë parasysh se *“duke vlerësuar rrezikun real që përndryshe do të ndodhte humbje e pamasë dhe e pakthyeshme, siç mund të shihet në konfiskimin e të ardhurave të konsiderueshme të planifikuara nga komuna e Graçanicës. Ky fakt, i cili mbështet propozimin për caktimin e masës së sigurisë, mbështetet nga Ekstrakti nga arkivi i lëndës Numri i referencës: SH-04/350/25 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Agjencia Kadastrale e Kosovës, Tabela e gjendjes së vjetër/Tabela e gjendjes së re (me njësitë kadastrale të ndara nr. 150-0, 155-0 dhe 17-8 ZK Graçanicë), gjendja e 10.03.2025”*.

Vlerësimi i Gjykatës

25. Me qëllim të vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata së pari rikujton bazën kushtetuese mbi të cilën kërkesa përkatëse është dorëzuar në Gjykatë.
26. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt”*.
27. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton:

“[...]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme.

[...]”

28. Më tej, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.”

29. Gjykata po ashtu rikujton paragrafin 1 të rregullit 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Në qfarëdo kohe, përderisa Gjykata të mos ketë vendosur lidhur me një kërkesë, çdo palë mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme lidhur me çështjen që është objekt i procedurës para saj, siç përcaktohet me nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit.

[...]

(3) Kërkesa për masë të përkohshme duhet të paraqitet me shkrim, duhet të përshkruajë faktet përkitazi me kërkesën, argumentet për të mbështetur kërkesën, masat e kërkuara dhe pasojat e parashikuara në mënyrë të arsyeshme nëse kërkesa miratohet. Pala që kërkon masën e përkohshme mund t'i bashkëngjisë kërkesës edhe dokumente dhe dëshmi të tjera që janë të rëndësishme dhe që e mbështesin kërkesën.

[...]”

30. Në fund, Gjykata rikujton rregullin 45 (Vendimarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Nëse gjyqtari/ja raportues/e i/e caktuar për kërkesën bazë, e vlerëson të nevojshme të trajtojë kërkesën për masë të përkohshme ndaras nga kërkesa bazë, atëherë ai/ajo përgatitë një raport të veçantë lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, brenda një afati të arsyeshëm.

[...]

(4) Kolegji shqyrtues rekomandon miratimin e tërësishëm ose të pjesshëm të kërkesës për masë të përkohshme nëse konstaton se:

(a) evitohen rreziqe ose dëme të pariparueshme nëse lejohet masa e përkohshme; ose

(b) vendosja e masës së përkohshme është në interes publik.

[...]”

31. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr.05/218] të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 28 gusht 2024, me pretendimin se i njëjti nuk është në përputhshmëri me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] të Kushtetutës, pasi konsideron (i) se nuk ishte njoftuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës apo Ministria kompetente e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; (ii) nuk është konsultuar gjatë përgatitjes së projektit të ndërtimit të qendrës banesore që do të realizohej në territorin e Komunës, që si rrjedhojë prodhon pasoja për Komunën e Graçanicës dhe kjo ka të bëjë me synimin e Qeverisë për të hequr pjesë të njësive kadastrale në një sipërfaqe të konsiderueshme që janë në pronësi të Komunës; si dhe (iii) si rrjedhojë e mosnjohimit dhe moskonsultimit, Komuna nuk i di detajet e mënyrës dhe kritereve sipas së cilave është vendosur dhe për çfarë arsye është përzgjedhur për ndërtimin e një objekti banesor për Organizatën bamirëse “*Jetimat e Ballkanit*”; (iv) Qeveria nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Ligjit nr. 08/L-125 për Pronën Publike, të cilave u është referuar me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kontestuar; (v) është vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duke e kufizuar Komunën e Graçanicës në ushtrimin e kompetencave vetanake; (vi) Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale i përket kategorisë kushtetuese të ligjeve me interes vital dhe si i tillë nuk mund të anashkalohet dhe as të zvogëlohen kompetencat e vetëqeverisjes lokale duke iu referuar ligjeve të tjera, që në rastin konkret është Ligji nr. 08/L-125 për Pronën Publike; si dhe (vii) Vendimi i Qeverisë cenon drejtpërdrejt interesat e Komunës së

Graçanicës si njësi e vetëqeverisjes lokale për sa i përket investimeve dhe projekteve të planifikuara, të gjitha me synim të arritjes së të ardhurave shtesë për rritjen e buxhetit.

32. Lidhur me këtë, bazuar në dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, masa e përkohshme mund të kërkohet nga palët (i) *“lidhur me çështjen që është objekt i procedurës para saj [Gjykatës]”*; me kushtin që pala që kërkon masë të përkohshme të arrijë të dëshmojë se (ii) masa e përkohshme është e nevojshme *“për tu evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme”*; ose që masa e përkohshme është në *“interes publik.”*
33. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet dhe faktet e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës ngrenë çështje të nivelit kushtetues që ndërlidhen me garancitë kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale dhe legjislacionin me interes vital, sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
34. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vlerëson se pezullimi i Vendimit të kontestuar mund të *“evito[jë] rreziqe apo dëme të pariparueshme”* që ndërlidhen me cenimin e mundshëm të përgjegjësisë dhe kompetencave komunale përkitazi me posedimin dhe menaxhimin e pronave komunale. Për më tepër, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar është në *“interesin publik”*, sepse i shërben sigurisë juridike ndërlidhur me pasojat eventuale që mund të afektojnë përgjegjësitë komunale, përfshirë dëmin e pariparueshëm që mund të pësojë buxheti i Komunës përkatëse, i cili rrjedhimisht mund të ndikojë në mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj.
35. Për pasojë, Gjykata, në dritën e sqarimeve të lartcekura, vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme ndaj Vendimit të kontestuar duhet të miratohet, sepse i shërben *“evitimit të rreziqeve ose dëmeve të pariparueshme”* dhe është në *“interes publik”*.
36. Gjykata, në fund rithekson se, miratimi i masës së përkohshme deri më 31 tetor 2025, nuk paragjykon në asnjë mënyrë pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 116 të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 45 të Rregullores së punës, më 31 korrik 2025, njëzëri:

VENDOS

- I. TA MIRATOJË kërkesën për masë të përkohshme, në kohëzgjatje deri më 31 tetor 2025;
- II. TA PEZULLOJË menjëherë zbatimin e Vendimit [Nr.05/218] të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 28 gusht 2024;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. TË KONSTATOJË se ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Remzije Istrefi-Peci

Nexhmi Rexhepi